



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

14-670/02-211179/ me 25. 10. 2023  
23

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110–391, të dt. 25.02.2010, dispozitive të nenit 29, paragrafi 29.1, nënparagrafi 29.1.3, shkronja d, të Rregullores së ndarjes së subvencioneve 01-020/01-19410/18 e dt. 08.08.2018 Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

**V E N D I M**

- I. **MIRATOHET** vendimi për ndarjen e bursave për Shpresat e Sportit të Komunës së Prishtinës për vitin 2023.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, Komuna e Prishtinës do të ndaj gjithësej 20 (njëzet) bursa për Shpresat e Sportit.
- III. Vlera e një burse ka shumë prej 1.000.00 € (një mijë euro).
- IV. Obligohet Drejtoria e Sportit të shpall konkurs për ndarjen e bursave për Shpresat e Sportit duke përcaktuar kriteret.
- V. Bursat për Shpresat e Sportit të Komunës së Prishtinës, të cekura në pikën II të këtij Vendimi do t’i ndaj Komisioni për ndarjen e bursave i caktuar me vendim të veçantë.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**I DOREZOHET :**

- Drejtorisë së Sportit;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**

